



**Hapet thirrja për mobilitete studentësh dhe stafi të UPT-së,
në kuadër të Programit Erasmus+ KA107
në Politecnico di Torino (POLITO), Itali.**

Në kuadër bashkëpunimit midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Politecnico di Torino, publikohet thirrja për mobilitete për studentë dhe staf të Universitetit Politeknik të Tiranës, në Politecnico di Torino.

PËR STUDENTË:

Llojet e mobilitetit përfshijnë: Shkëmbimin e studentëve për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët: Studentët duhet të kenë përfunduar vitin e parë të studimit, të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor ose Master të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Fushat e studimit: Të gjitha degët, sipas programit të lëndëve të ofruara nga POLITO për studentë ndërkombëtarë.

Kohëzgjatja e bursës: Semestri i I i vitit akademik 2026 - 2027

Numri total i studentëve: 2

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj* (Italisht ose Anglisht);
- Dokumenti Learning Agreement**.

Përparësi në nominimin e studentëve kanë studentët që u përkasin grupeve të disavantazuara.

Studentët që u përkasin këtyre grupeve të disavantazuara kanë përparësi edhe për trajtim financiar. (Studentë, prindërit e të cilëve kanë vdekur në krye të detyrës; studentë me ndihmë financiare; studentë me nevoja të veçanta; studentë prindërit e të cilëve kanë nevoja të veçanta, studentë që kanë marrë statusin e jetimit; studentë që kanë qenë viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore; studentë të grupeve etnike; studentë, prindërit e të cilëve ishin të dënuar të regjimit komunist; studentë, prindërit e të cilëve janë në pension etj.)



Key Action 1
- Mobility for learners and staff -

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është: Italian-B2; English-B2.*

Për kriteret e kërkuara nga POLITO për gjuhën italiane ose angleze, ju lutemi klikoni te:
<https://www.polito.it/en/education/international-students/exchange-students/erasmus-and-bilateral-agreements/language-requirements>

Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj. Preferohen: TOEFL iBT Certificate, Cambridge Certificate, IELTS Certificate.

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘Mobility Plan’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kurju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në POLITO lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti ‘Learning Agreement’ te seksioni ‘Commitment’ firmoset nga aplikanti, nga Drejtuesi i Departamentit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Bashkëlidhur gjeni formatin e ‘Learning Agreement’.

Për t’u njohur me listën e lëndëve të ofruara nga POLITO, ju lutemi klikoni te:

[International students | Politecnico di Torino \(polito.it\)](https://www.polito.it/en/education/international-students/exchange-students/erasmus-and-bilateral-agreements/language-requirements)

Bachelor degree programs: <https://www.polito.it/en/education/bachelor-s-degree-programmes>

Master degree programs: <https://www.polito.it/en/education/master-s-degree-programmes>

PËR STAFIN:

Llojet e mobilitetit përfshijnë: Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie.

Numri total i stafit akademik për mësimdhënie: 1

Koha e kryerjes së mobilitetit: 5+2 ditë, semestri i dytë i vitit akademik 2025-2026. Mobiliteti duhet të përfundojë brenda datës 31.07.2026.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:

- CV + lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t’u kryer në universitetin pritës*;
- Planin e Mobilitetit (Mobility Agreement);
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës



Key Action 1
- Mobility for learners and staff -

- Dokumenti i Mobility Agreement (Staff Mobility for Teaching) për stafin akademik në universitetin pritës**.

**Plani i mobilitetit, si dhe periudha e propozuar e mobilitetit për stafin, duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore ku aplikani bën pjesë.*

*** Mobility Agreement for Teaching për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarde e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

Personat e interesuar do të njoftohen në vijim për detajet lidhur me procesim e mësimdhënies dhe axhendën e aktivitetit.

Stafi pjesëmarrës në mobilitet, mbas përfundimit të tij, duhet të paraqesë një raport lidhur me aktivitetin, te departamenti përkatës dhe te Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit, si dhe dokumentacionin e përfundimit të mobilitetit.

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT:

Deri më 28 prill 2026, ora 12.00

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al dhe abeqo@upt.al